

## KONTROLLI I LARTË I SHYTYTIT, PIONIER NË AUDITIMIN E PERFORMANCËS DHE PLANIFIKIMIN STRATEGJIK TË TIJ

nga Elfrida AGOLLI – Audituese e parë,

Alfred ZYLFI – Auditues i lartë,

botuar në gazetën “Koha jonë”, më 30 maj 2014,

### **“Një objektiv pa plan është thjesht dëshirë”**

Sfida e Planit Strategjik 2013-2017 në KLSH është auditimi i performancës, si një nga llojet bashkëkohore të auditimit, e sjellë si risi e punës së saj audituese dhe promotor zhvillimi për drejtoritë apo zyrat audituese kudo në institucionet dhe agjensitë publike shqiptare.

Auditimi i performancës garanton një formë të ndryshme të llogaridhënies publike krahasuar si me auditimin e ligjshmërisë, ashtu edhe me atë financiar. Ndërsa dy auditimet e tjera fokusohen në saktësinë e të dhënave dhe veprimeve financiare, përputhshmërinë e procedurave dhe transaksioneve me kërkesat ligjore, auditimi i performancës është një mënyrë për të penetruar më thellë në mbarëvajtjen dhe arritjen e rezultateve të aktiviteteve të ndryshme financiare. Ai i jep përgjigje pyetjeve si: **“A po përfiton taksapaguesi vlerën e duhur për taksat që po shpenzohen në një aktivitet publik?”**, apo **“A mund të shpenzohen paratë më mirë dhe më mençur për të arritur rezultate më të mira?”**.

Auditimi i performancës është sot në fokusin kryesor të punës audituese të KLSH-së, *in tandem* kjo edhe me vendet e zhvilluara, sepse ai merret me shqyrtimin e pavarur të eficiencës dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizatave publike, duke iu përmbajtur ekonomicitetit dhe me synim identifikimin e përmirësimeve.

Në Projekt-Idenë e paraqitur me datë 14 Dhjetor 2011 në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financës së Kuvendit, **Kryetari i KLSH z. Leskaj** theksoi se: **“KLSH është përpara një sfide të fortë për ta përqendruar punën tek auditimi i performancës, pse ai i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike”**.

KLSH sot është në pararojë të këtij auditimi, i cili pothuajse nuk aplikohet në asnjë nga institucionet shqiptare dhe drejtoritë apo zyrat e tyre të auditimit, madje nuk e kanë të përfshirë edhe në planet e tyre për të ardhmen. Sigurisht ky lloj auditimi,

qasja, metodologjia, teknikat, kriteret, etj., që ai përdor, mund të kryhen edhe me asistencën, trajnimet dhe në bashkëpunim me KLSH, në mënyrë që ky auditim të urbanizohet si koncept dhe të krijohet një platformë e unifikuar për normimin dhe vlerësimin e performancës. Audituesit e KLSH të auditimit të performancës disponojnë kapacitetet dhe ekspertizën e nevojshme, për faktin sepse kanë aftësi të ndryshme dhe përvojë të gjerë me auditimet në subjektet e sektorit publik.

Në KLSH, Departamenti i Auditimit të Performancës ka zhvilluar një sërë auditimesh falë edhe ndihmës e eksperiencës së SAI-ve të tjerë si dhjetrajnimeve të zhvilluara me partnerët tanë ndërkombëtarë. Ky lloj auditimi në KLSH megjithëse në hapat e parë të planifikimit dhe zhvillimit të tij është përfshirë në përmirësimet ligjore të kërkuara Kuvendit për të marrë një konfigurim sa më të plotë ligjor e rregullator.

Planifikimi është një nga hapat kryesorë të auditimit të performancës, sepse duke u orientuar drejt, ai mund të shtojë vlerë për përmirësimin e 3E-ve të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizatave publike.

Planifikimi strategjik është baza nëpërmjet së cilës përcaktojmë prioritetet tona për auditimin e performancës dhe më pas përzgjedhim fushat për auditim. Strategjia është struktura përmes së cilës auditimet specifike që realizojmë lidhen me objektivat që duam të përmbushim nga puna jonë audituese për horizontin kohor të planifikuar.

KLSH dhe Departamenti i Auditimit të Performancës në planifikimin e auditimeve të performancës mbështetet kryesisht në këto faza;

*-Përcaktimin e fushave për auditim prej nga bëhet zgjedhja e temave specifike.* Numri i fushave gjithmonë është shumë i madh, ndërkohë që kapacitetet tona janë të kufizuara, çka na bën të jemi të kujdesshëm në përzgjedhjen e tyre.

*-Filtrimin e kriterëve përzgjedhëse që do të përdoren në përcaktimin e fushave për auditim.* Kriteri kryesor i yni është kontributi i auditimit në vlerësimin dhe përmirësimin e funksionimit të subjekteve që auditohen.

*-Vlera e shtuar që do të sjellë ky auditim.* Shtimi i vlerës nënkupton kursime financiare e jo-financiare për subjektin dhe taksapaguesin dhe ofrimin e njohurive dhe këndvështrimeve të reja për stafin e KLSH-së.

*-Problemet më të rëndësishme ose fushat më problematike.* Sa më i madh risku i pasojave mbi ekonomikitetin, eficiencën dhe efektivitetin e besimit publik, për fusha që do të auditohen aq më të rëndësishme priren të jenë problemet. Një

problem gjykohet si i rëndësishëm nga ana jonë kur auditimi do të ndikojë direkt në pëmirësimin e përdoruesit (subjektit) të raportit të auditimit të performancës.

-*Risqet ose pasiguritë.* Në planifikim ne mbështetemi edhe në analizën e riskut, sa më i madh të jetë interesi publik për këtë çështje që mendohet të auditohet, aq më të mëdha janë risqet.


Disa nga faktorët që mund të tregojnë risk të lartë janë:

- shumat financiare ose buxhetore;
- fusha që për nga vetë natyra e tyre janë me risk (prokurimi, teknologjia, çështjet mjedisore, shëndeti, etj.);
- ndryshime të kushteve, kërkesave, kontratave, etj.;
- strukturat menaxheriale janë komplekse dhe mund të ketë konfuzion mbi shpërndarjen e përgjegjësisive;
- nuk ka informacion të besueshëm, të pavarur dhe të përditësuar.

Planifikimi i subjekteve të cilat do të auditohen dhe përzgjedhja e objektit të auditimit të performancës realizohet edhe duke patur parasysh strategjitë e tyre, që kjo të ndihmojë në përcaktimin e objektivave dhe procesin përzgjedhës.

Nga eksperiencat marra nga institucioneve homologe disa prej tyre i përzgjedhin temat bazuar në zgjedhjet strategjike, në kriteret përzgjedhëse (për shembull duke iu përmbajtur llojit të auditimit të performancës, sferave politike, marrëdhënieve me reformat brenda sektorit publik, etj).

Një orientim për fokusimin e auditimit mund të japë dhe skema e mëposhtme:



Departamenti i Auditimit të Performancës në planifikimin e auditimeve të veçanta mbështetet në standartet audituese INTOSAI, ku audituesi planifikon auditimin në mënyrë të tillë që të garantojë se cilësia është e lartë, afatet kohore të jenë respektuar dhe puna të jetë kryer me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet. Në punën tonë është mbajtur parasysh se një plan i menduar mirë është kritik në auditimin e performancës. Një orientim tjetër i yni është se përpara se të nisë studimi kryesor, duhet patjetër të përkufizohen objektivat e auditimit, fokusi i tij dhe metodologjia për arritjen e këtyre objektiveve.

Në auditimin e performancës, përpara se të nisë studimi kryesor, është e rëndësishme të përkufizohen objektivat e auditimit, fokusi dhe metodologjia për arritjen e objektiveve. Kjo realizohet në formën e një para-studimi. Qëllimi i këtij para-studimi është të përcaktojë nëse ekzistojnë kushtet për realizimin me sukses të studimit kryesor, dhe nëse po, të gjenerojë një propozim auditimi me planin e punës bashkëlidhur.

Hapat më të rëndësishëm në gjenerimin e propozimit për auditim janë: përkufizimi i çështjes specifike që do të studiohet dhe objektivat e auditimit; përpunimi i skeletit dhe formës së auditimit; dhe përcaktimi i garantimit të cilësisë, grupit auditues, afateve kohore dhe burimeve të nevojshme. Gjithashtu e rëndësishme është të përpunohet kuptueshëm programi i auditimit në mënyrë që të arrihene auditimit, lehtësohet identifikimi i çështjeve domethënëse të auditit dhe përmbushen përgjegjësitë e caktuara.

Gjithashtu, faza e planifikimit është pjesë integrale e **Manualit të Auditimit të Performancës të KLSH** i cili është dokumenti i **vetëm** në gjithë administratën publike shqiptare që hedh bazat e punës për këtë lloj auditimi, mbi bazën e të cilin ne mund të ofrojmë asistencë dhe trajnime për drejtoritë ose zyrat e auditimit të brendshëm nëpër institucione.

**Manuali i Auditimit të Performancës të KLSH** synon të japë udhëzime bashkëkohore për audituesit që kryejnë auditime performance, duke bërë një përshkrim të të gjitha fazave që përshkon ciklin e auditimit të performancës, nisur nga planifikimi strategjik e deri tek kompletimi i raportit auditues. Manuali ofron një strukturë brenda së cilës audituesit mund të kryejnë punën e tyre audituese, duke cilësuar gjithashtu edhe referenca se si mund të konspektohet një informacion më i detajuar për çështjen në shqyrtim.